

| | |
|---|---|
| Familja<br>**Proseal** | Tipologjia<br>**Cordoni in polietilene espanso (filtene) per il riempimento del fondogiunto** |
| Linjat e produkteve<br>**• Aqua**<br>**• Floor** | Kategoritë e përdorimit<br>**• Ndërtimi i dyshemeve industriale prej betoni me performancë të lartë, me fibër të përforcuar**<br>**• Hidroizolim i nyjeve të lëvizjes ose nyjeve të ndërtimit** |
| Përbërësit<br>**Monokomponent** | Paraqitja<br>**Rrotull** |

PRS.0046

# FILTENE FONDOGIUNTO

Kordon shkume polietileni për mbushjen e lidhjeve

## **Kodi doganor**

3926 9097

## **Amballazhimi**

- Ø 10 mm Rrotull 25 m
- Ø 15 mm Rrotull 25 m
- Ø 30 mm Rrotull 25 m

## **Aplikimi**

- Aplikim manual

## **Përshkrimi** i produktit

Kordon shkume polietileni me pore të mbyllura, e ngjeshur, për t'i dhënë përmasat e duhura thellësisë së nyjeve të shpërndarjes (krijimi i "faqes së tretë" ose fundi i nyjes) para se të mbushen me mbyllës polimerikë PROTECH FLEX, PROTECH SIGILFLEX MONO o EG 91. E disponueshme në profile me seksione rrethore me diameter të ndryshëm që përshten me nyje të çfarëdo forme dhe përmase.

## **Të dhëna** shtesë

I përshtatshëm për çdo lloj bashkimi midis elementeve të parafabrikuara, mbushëseve, trupave të strukturave të ndryshme, ndarjeve, dyerve dhe kornizave të dritareve, dyshemeve. Futja e një materiali mbushës "bazë lidhëse" ka shumë funksione si në nyjet statike ashtu dhe në ato të zgjerimit: t'i japë nyjes përmasat e duhura, në formën dhe në madhësitë më të përshtatshme me vetitë e ngjitësit që do të përdoret, duke pakësuar shtysat e brendshme të vetë ngjitësit dhe në ngjitjen në mure; duke favorizuar gjatë mbushjes së nyjes, kontaktin e ngjitësit me muret anësore; reduktimin e konsumit të ngjitësit.

## **Konsumi**

N° 1 metër e FILTENE FONDOGIUNTO për secilin metër linear të bashkimit.

## Fushat e **përdorimit**

Mbushje e "bazës lidhëse" për çafrëdolloj bashkimi midis elementeve të parafabrikuara, mbushëseve, trupave të strukturave të ndryshme, ndarjeve, dyerve dhe kornizave të dritareve, dyshemeve.

## **Vetitë** kryesore

- Diametri: *10 - 15 - 30 mm*
- I pandezshëm
- Jetëgjatësi e pakufizuar
- Rezistent ndaj rrezeve UV
- **Ngjyrat** në dispozicion<br>Gri e errët

## **Shtresat** e lejuara

Beton, Parafabrikuara

IF YOU WANT TO SOLVE IT

azichem

**www.azichem.com**

Përditësimi më: **28/04/2021**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet ligjore mund të lexohen në www.azichem.it/disclaimer

## **Mënyra** e përdorimit

Diametri i FILTENE FONDOGIUNTO duhet të jetë rreth 25% më e madhe se gjerësia e nyjes për të lejuar një pozicionim të qëndrueshëm të profilit dhe për të krijuar një rezistencë të mjaftueshme ndaj presionit të ushtruar nga ngjitësi gjatë nxjerrjes.
Shtyni me një vegël me majë të rrumbullakët (pa maja të mprehta dhe prerëse), që e kalon gjerësinë e nyjes, FILTENE FONDOGIUNTO, deri në thellësinë e dëshiruar dhe në mënyrë të tillë sa të lërë në sipërfaqe një vend të thellë aq sa duhet për ngjitësin që do të vihet më pas. Normalisht thellësia e ngjitësit duhet të jetë përafërisht sa gjysma e gjerësisë së nyjes.
Shkuma e polietilenit nuk ndikohet nga tretësit që përmbahen në prajmer, por është praktikë e mirë që të mos aplikoni promotorin e ngjitjes PROTECH FLEX PRIMER në FILTENE FONDOGIUNTO, në mënyrë që të mos ndryshohen vetitë e anti-ngjitjes. Pra FILTENE mund të vendoset kështu në nyje pas aplikimit të prajmerit, kur arrihet "koha pa pluhur".
Është mirë që thellësia e ngjitjes (e rregullueshme sipas pozicionimit të FILTENE FONDOGIUNTO) tëmos e kalojë gjerësinë e vetë nyjes.



## Paralajmërime, Masa paraprake, **Ekologji**

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.
Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.
Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: www.azichem.com. Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: www.azichem.com.
Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose amballazhit të tij në mjedis.

IF YOU WANT TO SOLVE IT
azichem
Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398